

VAKËFI-PASURI E KOMUNITETIT TË MUSLIMANËVE

Besimi islam ka historinë e vet. Shumë dijetarë, shkencëtarë, historianë në shekuj kanë folur, kanë shkruar libra, kanë bërë analiza, janë marrë me historinë islame, me filozofi, teologji, jurisprudencë, astronomi e shumë çështje të tjera, por ajo që unë dua të hulumtoj është "Vakëfi", pasuri (pronë) e komunitetit musliman.

Me shpalljen e Kuranit të Profeti Muhamed a.s., Islami mori zhvillim të madh. Profetin Muhamed a.s. dhe besimin e tij, e përkrahën fillimisht të afërmit, xhaxhai, e shoqja, Hatixhja. Me shpejtësi të madhe u shtuan besimtarët që e përkrahën. Shpëngulja në qytetin e Medinës dhehtimi i besimtarëve muslimanë i krijoi mundësinë Profetit Muhammed a.s. të ndërtonte xhaminë e parë atje. Kjo xhami është edhe vakëfi i parë dhe mund të quhet pasuria e parë e komunitetit musliman. Shembullin e Profetit e pasuan shumë besimtarë bamirës muslimanë, në tërë botën islame. Për bamirësi u ndërtuan objekte kulti fetare, që janë bërë nga persona të veçantë, por edhe nga grupe njerëzish, dhe këto kryesisht në fshatra. Kështu filloi të rritet vakëfi fillimisht në numër, në ndërtimin e objekteve për aktivitete, kryesisht fetare, por jo si rritje ekonomike e financiare.

Disa besimtarë bamirës, së bashku me ndërtimin e objekteve të kultit, ndërtonin edhe objekte të tjera, në shërbim të tyre, i dhuronin pronat e tyre, tokë, ara, vreshta, ullinj, bagëti etj. Kështu filloi të shtohet pasuria (vakëfi), rritja ekonomike. E gjithë kjo pasuri u vu në shërbim të objekteve të ndërtuara, të besimit islam, në pagimin e hoxhallarëve dhe të administratës, të arsimit, të njerëzve në nevojë, të jetimëve etj.

Zhvillimi dhe përkrahja e Islamit në botën islame, pati ndikimin e vet edhe në Shqipëri, që erdhi, në radhë të parë, nga persona ushtarakë, të atyre që merreshin me tregti dhe nga bektashinjtë. Zhvillim të madh në Shqipëri, besimi islam mori gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, në vitin 1478, dhe gjatë konvertimit më të madh, i cili vazhdoi në shekujt XVI-XVIII.

Kultet e para të ndërtuara në Shqipëri janë para sundimit të

Perandorisë Osmane: xhamia në kala të Beratit, Elbasanit etj., çka vërteton se muslimanizmi në Shqipëri ka ekzistuar edhe para sundimit të Perandorisë Osmane.

Xhamia e parë në Shkodër është ndërtuar në vitin 1478, nga Bajaziti, në kohën e sundimit të tij, në Pazar të Vjetër, që mori emrin "Xhamia e Selvisë", meqë në atë vend u mbollën disa selvia, xhamia "Sulltan Muhametit" në kala "Rozafa" në vitin 1479 e me radhë të tjerat. (Evliaja Çelebija - "Sahatnamja" ose "Shqipëria 350 vjet më parë", përkthyer nga Sali Vuçiterni f. 131-137" dhe Hamdi Bushati - "Shkodra dhe Motet").

Në gjuhën arabe, "Vakëf" do të thotë i ndaluar, i bllokuar, i palëvizshëm. (Mekajis el-luga, Mu'xhem el-vesit, fq. 1051 etj.). Kurse fetarisht vakëfi është "Ruajtja e një pasurie dhe shpenzimi i përfitimeve të saj në rrugë të Allahut". (Fikhu Es-suneh 4/330). Argument për këtë është hadithi autentik, ku i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të) i thotë Umer ibn Hatabit për tokën e Hajberit, të cilën ai dëshironte ta jepte Sadaka; "Përdore terrenin e saj sadaka. Nuk shitet, as nuk dhurohet dhe as nuk trashëgohet, por shpenzohen frutet e saj", dhe Umeri e dha atë sadaka në rrugën e Allahut për skllëverit, të varfrit, të skamurit e udhëtarët." Transmetuar nga Buhariu (2764), Muslimi (1633), Tirmidhiu (1375), Mesaiu (3603), Ebu Daudi (2878), Ibn Maxha (2396) etj.

Imam Et-Tirmidhi, pas transmetimit të këtij hadithi, thotë: "Dijetarët që nga koha e shokëve të Profetit dhe të tjerëve që erdhën pas këtij, hadithin e marrin si argument. Nuk dimë që të ketë ndonjë mospajtim tek të parët e këtij umeti rreth ligjshmërisë së vakëfit, si për sipërfaqe (tokë që lihet vakëf) apo për diçka tjetër.

Sipas Ebu Hanifes, vakëfi është: "Ruajtja e një pasurie, në pronësi të atij që e ka kthyer atë në vakëf dhe dhënia sadaka e përfitimit të nxjerr prej tij". Kurse sipas Ebu Jusufit dhe Muhammed Esh-Shejbanit: "Ruajtja e një pasurie në pronësi të Allahut dhe dhënia sadaka e përfitimit të nxjerrë prej saj".

Vakëfet tradicionalisht kanë qenë institucione islame, në formë pasurish të tundshme dhe të patundshme, të lënë falas, me testament nga besimtarë të ndryshëm muslimanë. Vakëfet janë të hershme sa vetë besimi islam. Ato vinin gjithnjë në rritje në tri drejtime:

Së pari, nga lënia vakëf, pasuri me testament nga bamirës muslimanë që kishin pasuri dhe ishin me zemër të madhe.

Së dyti, nga ndërtimi i objekteve fetare dhe në vartësi të tyre

ndërtonin dyqane, apo dhuronin toka, vreshta, ullishte, bagëti etj., të cilat jepeshin me qira dhe fitimet i kalonin objektit për mirëmbajtje, pagimin e hoxhallarëve, myftinive etj.

Së treti, nga fitimet e pasurisë së lëshuar me qira. Këto rritnin të ardhurat ekonomike dhe me to mbahej administrata e myftinive dhe e Komunitetit Musliman.

Pasuria e vakëfit është përdorur kryesisht në mbajtjen dhe funksionimin e institucioneve fetare islame, për qëllime bamirësie, për mirëmbajtjen e objekteve të kulteve etj. Vakëfet kanë qenë prona të kategorisë private, por edhe të dhuruar nga shteti, sulltanët, pashallarët, vezirët etj., si p.sh., në Rragam 70 dynymë dhe në Zadrinë 45 dynymë.

Në Shqipëri vakëfet në përgjithësi përbëhen nga xhamitë, medresetë, toka, shtëpi banimi, furra buke, mejtepe, ruzhdije e medrese, dyqane, vreshta. Përveç dhurimit të individëve të veçantë, dhuruan pasuri edhe sulltanët, pashallarët, vezirët, në formë mylku. Ishte kjo lloj prone e dhuruar, për arsye se vendi ynë në atë kohë ishte një vend feudal me drejtim blegtoralo-bujqësor, pa fabrika, por me disa punishte private në formën e tyre artizanale. Pavarësisht se Shqipëria ishte një vend feudal me drejtim bujqësor, në shekullin XIV i plotësonte të gjitha nevojat e saj, pa pasur nevojë për të importuar shumë sende, prandaj ka jetuar në lumturi.

Feudalët dhe bajraktarët në Shqipëri, zotëronin pasuri të mëdha, si: shtëpi, troje, toka bujqësore etj. Këta zotërinj, në përgjithësi, dhe disa, në veçanti, që kishin një zemër të madhe, për bamirësi dhuronin, ndërtonin objekte kulti dhe, së bashku me to, ndërtonin edhe objekte në ndihmë të tyre, për të mbajtur me të ardhurat objektin e ndërtuar dhe tepricat i kalonin Komunitetit Musliman, në përgjithësi.

Në Shkodër ka shumë të dhëna, dokumente, vakëfname, që vërtetojnë lënien e pasurisë vakëf, së bashku me objektet e kultit dhe të objekteve të ndërtuara për to. Ndër dokumentet më të hershme në Shkodër është ai i vitit 1529, i Ali Begut, ushtarak, i cili i la vakëf xhamisë së lagjes Alibegaj (emrin e të cilit mori lagja) si më poshtë:

Më shënue pasurinë e dhuruar.

Mustafa Pasha, ishte vezir i Shkodës, në vakëfnamën e tij, në vitin 1833 i la një pasuri të madhe Myftinisë Shkodër (këtu përfshi edhe baballarët e tij), dyqane, hamame, hane, mullinj, të holla (akçe). Këta vezirë ndërtuan edhe dy medrese, njërën në lagjen Qafë dhe të

dytën në Pazar të Vjetër. Krahas tyre, ata lanë vakëf edhe të holla për të mirëmbajtur pagimin e myderrizëve e nxënësve të fshatit për t'u ushqyer. Me fondet e Mustafa Pashës u ndërtua Qytaphanja (biblioteka), siç është quajtur atëherë, dhe i dhuroi bibliotekën e tij të pasur me shumë libra. Ja lënia vakëf e vezirëve të Shkodrës:

1) 51 dyqane në Pazar të Vjetër, nga këto 9 pas shumë viteve u dëmtuan dhe mbetën truall.

2) 8 magazina të mëdha, nga këto 7 pas shumë viteve janë dëmtuar dhe mbetën truall.

3) 3 hane që ndër vite u shkatërruan dhe mbetën troje.

4) 2 mullinj uji për bloje etj.

Në nenin 1 të kësaj vakëfname, thuhet: "Kësaj here lëhet vakëf, nga ana ime, për gjithmonë; administrator e mbikqyrës (myrteveli), për sa të jetë gjallë, emërohet Ahmet ef. Hadri. Ai ka për të shënuar e për të dhënë nga të ardhurat e qirave vjetore të 330 dyqaneve që ndodhen në Pazarin e madh (Suki Sulltan) me gjithë tre çerekë e gjysëm dyqanesh të tjera që janë po në atë Pazar... Nga të ardhurat e përmendura, mbasi të zbriten shpenzimet për riparime të dyqaneve dhe të magazeve, teprica duhet të ruhet më parë për ndërtesën e bibliotekës që do të ndërtohet si dhe për t'iu paguar detyrën e caktuar vjetore ruajtësve të librave të asaj biblioteke"...

Krahas bibliotekës renditen edhe objekte të karakterit social.

Neni 3: Mësuesit të mejtepit të lagjes Ndocej, i ndërtuar dhe i lanur vakëf nga ana ime, t'i paguhet rroga e detyrës.

Neni 4: Të pastrohet ose, në qoftë se lind nevoja, të riparohet saranxha (rezervuari) që është në kala të Drishtit.

Neni 5: T'i jepet rroga imamit, myezinit dhe të paguhen shpenzimet e xhamisë së Draçinit të ndërtuar me iniciativën e gjyshes sime.

Neni 6: Për të paguar imamin e myezinin e xhamisë së ndërtuar prej etërve të mi, e cila është përballë medresesë së poshtme si dhe shpenzimet e tjera në rast se nuk ia plotëson vakëfi i saj.

Neni 7: ... tepricat që ngelin nga ajo, më parë të jepet rroga mujore studentëve (talebeve) të medresesë e pjesa tjetër studentëve që ndodhen në Ramazan. Të paguhet rrogë e përditshme. Sulejman ef. Fakos etj. (Hamdi Bushati: "Bushatlinjtë", f. 209- 210).

- Vakëf la edhe Hasan Hoti: 5 dyqane në Pazar të Vjetër.

- Sheh Magripi, ish-imam, në xhaminë e lagjes Karahasej, la Vakëf 11 dynym tokë, shtëpi banimi, një pjesë të bibliotekës së tij etj. (10. AQShSh. Viti 1926, dosja 20 fl.)

- Në akce (kesh) u lanë edhe për mësuesin e mejtepit të xhamisë Ajasëm etj. E shumë të tjerë, si Haxhi Agë Lohja, që përveç që ndërtoi xhaminë, ndërtoi edhe 11 dyqane. Haxhi Agë Kopluku, i cili ndërtoi xhaminë në Serdarej dhe la tokë vakëf për vorreza dhe lekë për pagimin e imamit dhe të myezinit (10. Ditari i Hasan Agë Koplikut, ruhet në shtëpinë e Xhabijej).

- Ismail bin Sali i dhuroi xhamisë së Fushës së Çelës dyqane.

- Ashëf Pasha la 5 dyqane xhamisë Plumbit. (Hamdi Bushati).

- Hava Hanmi la vakëf 9 mijë akçe dhe caktoi myteveli Ymer Mustaf ef., me kusht që nga një mijë akçe në vit të tërhiqen 120 e me interesin e 5000 mijë akçeve, në çdo vit, në muajin Rebiul Evel, kujdestari do të përgatiste gjellë e do të këndonte mevludin. (Hamdi Bushati: "Bushatlinjt", f. 193-194).

- Jusuf Begolli la në Bushat, 50 dyqane hajrat. (Evliaja Çelebija - Sahatnamja ose Shqipëria 350 vjet më parë e përkthyer nga Sali Vuçiterni, f. 137-138)

- Në zonën e Oblikës, dy plaka, njëra ishte Hysdemja, e cila me shpenzimet financiare të saj ndërtoi xhaminë në fshatin Shtuf, në tokën e saj dhe la edhe të holla. Plaka tjetër nga fshati Vallas ndërtoi me shpenzimet e saj në bahçe xhaminë. Ajo la një sasi të madhe faqelli për të larë xhenazet etj. Ky faqell ka mbërrit deri në vitin 1967. Hafiz Musa Hoxha, imam në atë xhami, thotë: "Unë kam larë xhenaze me këtë faqell". (Smajl Bala: "Institucionet islame dhe hoxhallarët e Shkodrës", f. 516)

Ka shumë individë bamirës, të cilët nuk deshën të identifikoheshin.

Të gjithë ata që reflektonin mëshirën dhe dashurinë për të kryer veprime për bamirësi në shërbimet vakëfnore dhe mëshirëbërëse të tyre, kanë treguar vëmendjen, delikatesën dhe përpjekjen më të madhe për ruajtjen e nderit dhe të dinjitetit të njerëzve, të të vobektëve, të vejushave dhe të jetimëve. Delikatesë e tillë ishte krijimi dhe caktimi nëpër xhami të gurëve të sadakasë (gurët e lëmshës ku liheshin lëmshat). Këta gurë kanë qenë në formë shteri të çelur në mes, në formë grope, e aty liheshin lekët, asokohe dhe merreshin nga njerëzit më në nevojë, duke mos e ditur as ai që e la lëmshën dhe as ai që e mori lëmshën. Pra, me qëllim për të

siguruar që dhënësit e lëmoshës të mos e shihnin njëri-tjetrin, siç bëhej shpërndarja në errësirën e natës, nëpër shtëpi, e ushqimeve për nevojtarët, me qëllim për të mos e dëmtuar dinjitetin e tyre, janë një mënyrë sjelljeje shembullore, përmes së cilës mëshira dhe dashuria realizoheshin në përmasa ideale. Madje ngritja e një vakëfi që kompensonte dëmet e bëra pa dashje nga shërbëtorët për të mos lëshuar zemrën, është një thellësi njerëzore shembullore e tej çdo parashikimi.

Është shembull i mirë i disa besimtarëve bamirës muslimanë, që bënë fole të ashtuquajtura “ Shtëpia e zogjve” nën strehën e ndërtesave për strehimin e zogjve dhe që ngrinin vakëfe (ushqime) për lejkët e plagosur që nuk shtegtonin dot kur vinte koha e shtegtimit.

Vakëfet kryesisht përbëheshin nga prona private, por në Shqipëri u lanë vakëf në shek. XVII-XVIII edhe toka shtetërore. Në kohën kur sundonte Sulltan Sulejmani, u kthyen në vakëf edhe mulket, tokë në Zadrimë, afërsisht 45 ha, dhe në Rragam 75 ha.

Ky shembull është edhe në jug të Shqipërisë.

Pasuria e lënë vakëf, kur dhurohet, mbetet e paprekshme nga askush, as nga atë që e dhuronin një herë. Ajo që është lënë vakëf, nuk mund të shitet dhe as të kthehet në pronë të individëve dhe as të atyre që e kishin dhuruar. Hoxhë Didiu, i cili u akuzua se lexonte Kuranin, në fshehtësi, gjatë zhvillimit të gjyqit ndaj tij, ka thënë: “Pronat e vakëfit janë të shenjta, të paprekshme”. (Gazeta “Drita Islame”, viti XVI, nr. 7 (294), f. 11, korrik 2007). Kjo rrugë e bazuar në Sheriat, bëri që shumë pronarë bamirës të mos ngurronin t’u dhuronin pronat e tyre të kësaj kategorie institucioneve islame. Sipas rregullit të vakëfit, ata caktonin myrtevel (kujdestar), që të vepronin në mënyrë të ndershme në vjeljen dhe evidentimin me rregull të të ardhurave të kësaj pasurie.

Sipas përcaktimit të Ebu Hanifes, vakëfi mund të mos jetë më vakëf, nëse ai që e ka kthyer pronën e tij vakëf, e ndryshon atë, por ka dy kushte:

E para: që pronari të mos ketë kushtëzuar që prona e tij të kthehet në vakëf pas vdekjes së tij.

E dyta: të mos jetë përcaktuar kjo gjë nga kadiu (që të mbetet vakëf), në një rast të tillë lejohet shitja e tij; ndryshe ajo mbetet vakëf (6- Shih Mukhteser el-hudurij, kapitulli i vakëfit, f. 283). Ndërsa sipas shumë nxënësve të Ebu Hanifes vakëfi mbetet përherë i tillë,

edhe nëse pronari i tij i parë ndryshon mendim. Ebu Jusufi thotë për hadithin e mësipërm: Nëse ky hadith do t'i kishte mbërritur Ebu Hanifes, ai do të kishte thënë po të njëjtën gjë.

Pra, vakëfi konsiderohet si pronë vetëm e Allahut xh.sh. dhe nuk shitet, nuk dhurohet, nuk tjetërsohet, nuk trashëgohet dhe as nuk lejohet që në një mënyrë apo në një tjetër, të humbasë rolin e tij si vakëf. (8- Shih Mukhteser el-kudurij, f. 287, El-Indajeti Sherh el-Bidaje 3/13, fikh Es-suneh 4/335).

Dijetarët hanefi dhe të tjerë kanë dhënë fetva se, nëse vakëfi shitet, kjo është e pavlefshme (batil). (9 Shih Hashijetu ibn Asidin 5/57).

Siç e thamë më sipër, personi i cili kthen pasurinë e tij vakëf, këtë e bën për të arritur shpërblimin e Allahut xh.sh, edhe pas vdekjes së tij. Për këtë, Profeti a.s. thotë: "Kur njeriu vdes, atij i ndërpriten veprat, përveçse në tre raste:

- Kur ai lë një sadaka të rrjedhshme.
- Kur ai lë një dije nga e cila përfitohet.
- Kur ai lë një fëmijë të mirë i cili lutet për të.

(12 Transmetuar Muslimi, Ebu Dauti, Nesaiu etj.)

Prandaj sadakaja është pikërisht ajo pasuri që lihet vakëf. Nëse vakëfi humbet nga papërgjegjshmëria e të tjerëve, kjo do të thotë që personi, i cili e ka lënë vakëf, do të privohet nga shpërblimi i saj pas vdekjes. Kjo përbën thyerje të pronës së muslimanit dhe privon ato të ardhura që vilen nga ky vakëf. Tjetërsimi i vakëfit, në çdo lloj forme qoftë, nuk lejohet, por a lejohet zëvendësimi i tij? Po, lejohet zëvendësimi i tij në dy raste:

Në rastin e parë; Kur zëvendësimi i tij bëhet i domosdoshëm, apo i nevojshëm. Dhe kjo kur ai e humbet vlerën e tij plotësisht, si p.sh. një xhami e braktisur, apo është prishur, në të cilën nuk falet më njeri. Në këtë rast lejohet zëvendësimi i tij me një tjetër. Ky zëvendësim bëhet duke shitur vakëfin e parë me shumën më të mundshme dhe me këtë shumë të blihet apo të ndërtohet vakëfi i dytë, i cili duhet të ketë të njëjtin destinacion, si i pari. (14 Shih Hashijetu ibn Asidin 4/ 386) (15 po aty).?

Në rastin e dytë; nëse vakëfi me të cilin kërkohet të zëvendësohet, është më i mirë se i pari dhe më me shumë të ardhura, sipas disa dijetarëve hanefi, një gjë e tillë lejohet.

(16 Shih Fikhes-sunneh kitabul vakf, el-insaf, etj).

Në vakëfe lejohet të bëhen investime për rritjen e të ardhurave, pasi vet vakëfi është një investim nga i cili merren të ardhura të vazhdueshme, duke ruajtur kështu kapitalin fillestar.

Kur e lejon sheriati të bëhen investime, me qëllim që të rriten të ardhurat dhe mund të zëvendësohen, në pronat e vakëfit janë:

1). Dhënia e objektit me qira.

2). Dhënia e qirasë me dy vlera.

3). El-hikr, që do të thotë dhënia e tokës së vakëfit për një kohë të gjatë dhe lënia në dorë të qiramarrësit. (24dr. Halifetu Baberk el-Hasan- Fikhut Islam f.21).

4). El-Muradas, lidhja e një akt-marrëveshjeje mes administratorëve të vakëfit me qiramarrësin për investimin në tokën e vakëfit. (31 Hashijetu ibn Abit 4/402, Bedajatu el-muxhtehit 2/236, Mexhmua El-FETAVA ibn Tejmije 31/224).

5). Dhënia me qera e tokës për një kohë të gjatë, ku në fund toka i takon vakëfit. (32 El-Ixharetu bi temlike butuar nërevistën Akademike së Dikhut Islam në 12).

6). Ortakëria në mes vakëfit dhe investitorit (33 Studimet dhe mendimet e konferencës së parë të financës islamike, zhvilluar në Dubaj me 23-25. 6.1399 hixhrij(1978).

Pronat e vakëfit janë lloje të ndryshme, të tundshme dhe të patundshme dhe në përgjithësi ndahen;

1) Të sekuestruara (mazbut).

2) Të mbështetura (mylhaka).

Të sekuestruara mazbuta, quhen vakëfe, që ishin lënë në formën e pasurisë së luajtshme dhe administroheshin drejtpërdrejt nga zyrat e vakëfit dhe duke i dhënë me qira.

Të mbështetura (mylhaka), quhen vakëfe, të cilat administroheshin nga myrtevelit të caktuar të zyrave të vakëfit.

(A.Q.SH.SH. f.482 viti 1923 dosja I, fleta 44- Rregullore “Mbi organizimin e vakëfeve muslimane në Shqipëri”, neni 26,27,28)?

Pasuria e vakëfit ka ardhur gjithnjë në rritje, nga dhurimi i bamirësve të veçantë e me zemër të madhe, gjatë viteve dhe shekujve. Ato, një pjesë të pasurisë së tyre, sa ishin gjallë e dhuronin me testament ose amanet Komunitetit Musliman. Kështu që, bamirësit sa vinin e shtoheshin, por shtoheshin edhe pasuria e vakëfit.

Vakëfët muslimane janë të hershme, sa është edhe besimi Islam dhe për t'i administruar saktë dhe me pastërti, janë ngritur organizma dhe administrata, që të merreshin drejtpërdrejt me këto prona të dhuruara vakëf.

Fillimisht vakëfet në Shqipëri nga Shejhul Islami (I pari i fesë Islame) në Stamboll, nëpërmjet drejtorisë së Vakëfit të Shqipërisë. Drejtor i vakëfit para vitit 1913 ka qenë Mustafa Eshref Efendia.

Mbas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë filluan të merren disa masa administrative nga qeveria e Ismail Qemalit. Ajo ngarkoi Haxhi Vehbi Dibrën, në detyrën e kryetarit të Komunitetit Musliman të Shqipërisë. Si rezultat i punës së tij me ulemat (dijetarë) shkodranë e të gjithë Shqipërisë, në Shkodër, në muajt e parë të vitit 1916, krijuan Gjygin e Lartë të Sheriatit nën drejtimin e Haxhi Vehbi Dibrës.

Me krijimin e Gjygit të Lartë të Sheriatit, u krijua edhe drejtoria e përgjithshme e vakëfëve të Shqipërisë dhe administrata e saj.

Nga hulumtimet vërtetohet se para viteve 1912-1913, në kohën e qeverisë otomane ka ekzistuar drejtoria e Vakëfit të Shqipërisë, e cila drejtohej nga Mustafa efendia, por nuk la asgjë, nuk trashëgoi asnjë dokument, nuk bëri asnjë kontroll e as regjistrime të pasurisë së Vakëfit.

Drejtoria e Vakëfit u krijua në fillimet e muajit Maj 1916, u emërua kuadri drejtues e administrativ dhe u fillua nga puna.

Një ndër detyrat më të rëndësishme dhe të domosdoshme të drejtorisë ishte nxjerrja dhe evidentimi i plotë i të gjithë pasurisë së vakëfit të Shqipërisë së bashku me objektet e kultit e të arsimit, të dyqanëve e tokave, etj. Duke i vlerësuar edhe në vleftë leku të asaj kohe, në f.ar.

Puna e nisur ia arriti qëllimit në muajin tetor të vitit 1917.

Nga hulumtimet e bëra në A.Q. të SH. Shqiptar, së bashku me z. Blendi Alushi vërtetohet një punë e tillë, në vitin 1917, 1919, 1923, 1926 dhe dosje pa vite në gazetën "Drita Islame".

Nga regjistrimet e bëra rezulton që pasuria e Vakëfit e Komunitetit Musliman të Shqipërisë janë si më poshtë ;

296 vakëfe të ndryshme. Pasuria e patundshme (Emvali gajri menkule) k. 781.270, çmimi i ndërtesave (musakafer) k. 536. 385, (mustagalat - tokat) etj, së bashku k. 1.317.655,

Pasuria e tundshme (Emvali menkule) k.229.234, gjithsejt,

k.1.546,889, mbledhje e gjithanshme, veç kësaj 451 ndërtesa feje (hajrat); 250 xhami, 73 ndërtesa shkolle, 128 të tjera ndërtesa feje.

Tërë kjo punë e madhe përfundoi në muajin tetor siç thamë dhe me 23.10.1917 u muar në analizë në Drejtorinë e Përgjithshme të Vakëfit të Shqipërisë.

Në mbledhjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfit morën pjesë;

Kryetari i Komunitetit Musliman të Shqipërisë, Haxhi Vehbi Dibra, Përgjegjësi Civil P e R Augusto ven Kral i Austrisë në Shkodër, Izet effendi Pertev, Drejtori i Përgjithshëm i Financës, Fejzi Beg Alizoti, prej Ulemash, Halid efendia, prej popullit Musa Juka, Hasan efendi Begteshi. Hysejn effendi Vuthi por nuk mori pjesë për arsye shërbimi. Protokolli u mbajt nga sekretari i vakëfit z. Ali efendi Borshi.

Mbledhja filloi në orën 10 paradite dhe kryemyftiu përshëndeti të pranishmit. Në këtë mbledhje foli dhe August Kral dhe pastaj filloi rendi i ditës ku e mori fjalën z. Ali ef. Borshi i cili shpjegoi parashkresën e përshtatshme të vakëfit që u pëlqye dhe u mbështet sipas urdhëresës të dt, 2.7.1917.

Pas parashkresës u dha evidenca e pasurisë së vakëfit të Shqipërisë që e thamë më lartë dhe u vlerësua puna e bërë. Pastaj mbledhja nxori konkluzione dhe mendime të vlefshme për punën në të ardhmen.

Për përmirësimin e punëve në rrethe e qarqe, prefekturë e nënprefekturë të krijohen komisionet e vakëfëve në këto struktura, etj.

Me pëlqimin e drejtorit të vakëfëve u paraqit mendimi që nga të gjithë vakëfet sirt, e pas vakëfëve që janë evdadijet, ti jepen drejtorisë së vakëfit të cilat të jepen me fajde.

U pëlqye pa asnjë kundërshtim mendimi i Fejzi Beg Alizoti i cili tha: "që të gjitha kapitalet e vakëfëve të cilat nuk janë evladije të mërren prej myrtevelive e të vendosen në bankë me fajde".

U pëlqye që për kapitalet e vakëfit sirt të kërkohet prej myrtevelive, ku në rradhë të parë të merret vesh sasia e vërtetë, e kështu me vonë të shënohet mënyra e përdorimit të tyre, e bashkë me këto, punimi i një parashkresë t'i dërgohet komisioneve.

Këtu paraqitet mendimi i vet drejtorisë së vakëfit që ndër vendimet e komisioneve të vakëfit të mos jetë i nevojshëm hyqmi i

sheries, i posaçëm prej kadisë, mbasi kadija (Naip) vetë gjindet në këtë komision, si kryetar.

Drejtori i përgjithshëm i vakëfit paraqet mendimin që të dhënat e vakëfit të mbliidhen nga drejtorja e financës dhe të bëhet pasqyra e tyre. Në çdo gjë që do të veprohet të marrë pjesë edhe një përfaqësues nga vakëfi.

Në këtë mbledhje u morën edhe disa mendime të tjera në lidhje me pasurinë e vakëfit të Shkodrës.

Vitet kalojnë dhe të ardhurat gjithnjë vinin në rënie dhe fitimi filloi të mos përballojë shpenzimet e saj. Prandaj në vitin 1938 u dha një fond nga buxheti i shtetit. Mbas pushtimit të Italisë fashiste të Shqipërisë qeveria e saj i dha Komunitetit Musliman të Shqipërisë 375.000. fr.ar. (41- Historia e Popullit Shqiptar vol. IV- maket f.11).

Lufta për çlirimin e vendit e dobësoi edhe më shumë. Në këtë vit në një tremujor, me kërkesën e këshillit lokal në Shkodër iu miratua Myftinisë Shkodër 1700 fr.ar për riparimin e objekteve, kryesisht në qytet. Në këtë gjendje Komuniteti Musliman i Shqipërisë, me 20/2/1945, iu drejtua me një qarkore të gjithë zyrave të Myftinive të rretheve dhe nëpunësve të saj, që të bashkëpunojnë me këshillat lokalë të shtetit, me qëllim për të mirëmbajtur me kujdes pronat, që zotëronin Myftinitë në rrethe dhe qarqe të Shqipërisë.

(42- A.Q.SH.SH. f.482 viti 1946 dosja 56, fl 162).

Me çlirimin e vendit, qeveria e dalë nga lufta mori disa masa si dhe reformën agrare të vitit 1945, që u kthye në ligj me nenin 108 datë 29.8.1945.

Në kapitullin e parë

Tokat që goditen nga shpronësimet dhe përjashtimet.

Neni 1

Me shpalljen e kësaj ligje shpronësohen detyrimisht dhe u ndahen fshatarëve nënshtetas shqiptarë që skanë tokë të tyre, ose toka nuk u mjafton.

Neni 3

Në këtë numër thuhet: "Pronat bujqësore private dhe të enteve private dhe fetare me përjashtim dhe përcaktimet e përshkruara në nenin 2 të kësaj ligje".

Me këtë ligj filloi dalëngadalë shuarja e pasurisë së vakëfit të Myftinisë Shkodër dhe të gjithë Shqipërisë.